

Master i Shkencave në **Menaxhim Mjedisor Urban** (120 ECTC, 2 vite akademike)

Profili profesional

Ky program synon specializimin e thelluar të studentëve të cilët kanë kryer studime të ciklit të parë në fusha të njëjta dhe / ose të përafërta. Programi synon të garantojë formim të avancuar dhe kompetenca të specializuara përmes dhënies së njohurive teorike dhe praktike më të thelluara në fushën e menaxhimit mjedisor urban. Programi synon gjithashtu të fokusoj studentët në komponentët e menaxhimit, politikëbërjes në funksion të mjedisit të qëndrueshëm dhe cilësisë së jetës, përfshi edhe menaxhimin me ndjeshmëri mjedisore të ndërmarrjeve private duke formuar një figurë profesionale që balancon njohuri të fushave inxhinierike, planifikuese dhe shkencore me ato menaxheriale.

Temat kryesore që trajton ky program studimi:

- *Formim i pergjithshem*
Qeverisje vendore; Metoda të kërkimit shkencor; etj
- *Formim në disiplina ndihmëse*
Planifikim Transporti dhe menaxhim trafiku; Toksikologjia dhe Ndotja Mjedisore; Ekonomi mjedisore
- *Formim i thelluar në profesion:*
Menaxhimi i ujit; Menaxhimi i tokës bujqësore; Menaxhimi i zonës bregdetare; Legjislacion mjedisor; Planifikim Rajonal, Praktika mjedisore lokale, etj.

Mundësitë për punësim

Sektorët kryesorë të punësimit përfshijnë:

- Sektori privat i kompanive apo studiove të konsulences e projektimit në fushën e mjedisit; në kompani të biznesit privat për garantimin e standarteve mjedisore në performancën e këtyre kompanive; si ekspert në skuadra shumëdisiplinare që ofrojnë konsulencë në planifikim dhe menaxhim urban; i njëjti shërbim mund të ofrohet nga këta ekspertë edhe në kuadrin e organizatave ndërkombetare si Banka Botërore, Institucionet Europiane, UNDP të cilat kanë mjedisin si një kriter shumë të rëndësishëm vlerësimi dhe zbatojnë projekte të shumta në këtë fushë jo vetëm në Shqipëri por edhe në vende të tjera.
- Sektori publik Në nivelet e ndryshme të qeverisjes qendrore dhe vendore dhe pritet të sjellin një impakt të ndjeshëm në qeverisjen dhe kontrollin e territorit të bazuar në konceptet e menaxhimit mjedisor urban; në nivelin e qeverisjes qendrore;
- Institucionet kërkimore shkencore vendase dhe të huaja të cilat kanë për fokus kryesor fushën e mjedisit dhe menaxhimit mjedisor urban.

Plani Mësimor si më poshtë vijon:

Plan Mësimor sipas tipeve të veprimtarive i programit të studimit

Master i Shkencave në Menaxhim Mjedisor Urban

Fusha disiplinore	Veprimtari formuese	Kredite	Kredite total	Kredite (%)
A (formim baze i përgjithshëm)	Metoda të kerkimit shkencor	3	9	8%
	Qeverisje vendore (Menaxhim Mjedisor Lokal)	6		
B (karakterizuese)	Menaxhimi i tokës buqësore	6	48	40%
	Legjislacion mjedisor	6		
	Planifikim Rajonal 1	6		
	Planifikim Rajonal 2	6		
	Menaxhimi i zonës bregdetare	6		
	Praktika Mjedisore Lokale (Politika Mjedisore)	6		
	Menaxhimi i ujit	6		
	Sherbime publike (Planifikim Mjedisor)	6		
	C (integruese)	Toksikologjia dhe Ndotja Mjedisore 2		
Planifikim Transporti dhe menaxhim trafiku		6		
D (me perzgjedhje)	Lende me perzgjedhje 1	6	15	13%
	Lende me perzgjedhje 2	3		
	Lende me perzgjedhje 3	6		
E (formuese plotesuese)	Ekonomi mjedisore (Sipermarrja dhe biznesi)	6	15	13%
	Planifikim peizazhi	6		
	Internship profesional	3		
F (Pergatitja tezes)	Teza dhe Projekt Diploma	24	24	20%
TOTAL		120	120	100%